

## **Raporti i punës i Shërbimit Sprovues të Kosovës, janar-dhjetor 2009**

E tërë puna e Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK), udhëhiqet dhe mbikëqyret nga drejtorja e përgjithshme e SHSK-së, në Prishtinë. Në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës funksionojnë edhe pesë qendra regjionale si që janë: (Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Pejë dhe në Gjilan)

Shërbimi Sprovues është përgjegjës për ekzekutimin, mbikëqyrjen, korrektimin, risocializimin, rehabilitimin dhe ri integrimin në shoqëri e të gjithë personave të dënuar me masa dhe dënime alternative si dhe të personave të liruar me kusht nga burgu

### **I. Baza ligjore e punës së Shërbimit Sprovues të Kosovës**

Bazë ligjore për punën e Shërbimit Sprovues në Kosovë (Shërbimi për Ekzekutimin e Dënimeve Alternative dhe Ri integrimin Shoqëror të Personave të Dënuar) janë: Kodi i Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për të Mitur dhe Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale,.

Shërbimi Sprovues i Kosovës duke u bazuar në ligjet (kodet) e Kosovës është i kyçur në mënyrë aktive që nga fillimi i procedurës penale përgatitore për të akuzuarin, duke filluar me anketa sociale-raporte para ndëshkuese.

Po ashtu në mbështetje të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve Penale, Shërbimi Sprovues i Kosovës ekzekuton të gjitha masat dhe dënimet alternative dhe bën mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu si dhe ri integrimin e tyre në shoqëri dhe komunitet.

### **Kushtet e punës**

Gjatë këtij viti SHSK, ka mbuluar me punën e vetë, tërë territorin e Kosovës. Në të gjitha qendrat e Shërbimit Sprovues, hapësirat e punës, zyrtat janë në objekte private , përveç qendrës regjionale të Prishtinës e cila duhet ti përmirësoje kushtet e punës, pasi janë te vendosur ende në kotinjerë. Të gjitha qendrat regjionale te SHSK-së janë pajisur me telefon dhe internet.


### **Ngritja e kapaciteteve -Trajnimi i stafit në Shërbimin Sprovues**

Gjatë kësaj periudhe kohore është përmbushur edhe objektiva planifikuese e trajnimeve për personelin e Shërbimit Sprovues. Kanë marrë pjesë në trajnime **58 zyrtar të stafit** të Shërbimit Sprovues. Këto trajnime janë organizuar nga: UNICEF-i, ku janë realizuar për punen me të mitur 7 module për SHSK ,ku janë trajnuar 10 trajner në projektin (TOT),dhe gjithë zyrtaret sprovues (48 zyrtarë) janë trajnuar për këto module. I njëjti trajnim ka vazhduar edhe për modulën e 8 për të mitur Ndihmë pas lirimit. Pastaj UNIFE-mi me



Gjithsej	1522	41	1563	1523	8	4	8	20
%	97.40	2.60	100	97.4	0.51	0.26	0.51	1.27

Grafikoni i anketave sociale



### III. 1. Masat dhe dënimet alternative

Numri i përgjithshëm i masave dhe dënimeve alternative për këtë vit është 607 raste, prej tyre 561 raste janë të mitur ose (92.42%) kurse 46 raste janë madhor ose (7.56%) Nga ky numër i përgjithshëm i rasteve, të përfunduara me sukses janë 239 raste, nuk kanë mund të ekzekutohen 14 raste për arsye të ndryshme, kurse në ekzekutim janë 354 raste. Struktura gjinore e këtyre rasteve është : meshkuj 596 raste apo (98.28%) , dhe femra 11 raste apo( 1.80%).

Gjatë kësaj periudhe kohore Shërbimi sprovues ka ekzekutuar këto masa dhe dënime alternative:

- **Mbikëqyrje e shtuar nga prindi dhe Shërbimi Sprovues** janë 284 raste, prej tyre mbikëqyrjen e kanë përfunduar 20raste.
- **Urdhër për punë pa pagesë” UPDP”**kemi pas 128 raste, prej tyre të mitur janë 90 raste dhe madhor 38 raste. Me sukses e kanë kryer këtë masë - dënim 84 raste, kurse në ekzekutim janë 44 raste;
- **Me masa diversiteti** kemi pas 190 raste, prej tyre 151 raste janë kryera me sukses, kurse ne ekzekutim janë 39 raste;
- Me **Urdhrin për trajtim te detyrueshëm rehabilitues në liri** janë në ekzekutim 5 raste madhor.

- **Njoftime ka marrë SHSK-ja nga ana e gjykatave edhe për 32 rastet me dënimin - Qortim gjyqësor**

Zyrtarët sprovues kanë marrë pjesë në 870 seanca gjyqësore, prej tyre 754 në Gjykatat komunale dhe 116 seanca në gjykatat e qarkut.

Tabela e strukturës së rasteve me masa dhe dënime alternative

Qendrat Regjionale	M	F	Gjithsej	Shqiptar	Serb	Boshnjak	REA
<b>Gjithsej</b>	<b>596</b>	<b>11</b>	<b>607</b>	<b>580</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>16</b>
Përqindja %	98.02	1.80	100	95.55	0.49	1.32	2.64

#### **IV. Lirimi me kusht i personave nga burgu**

Lirimi me kusht kryhet nga Paneli për Lirim me Kusht. Personi i liruar me kusht obligohet që gjatë periudhës së lirimit të tij me kusht të raportojë Shërbimit sprovues sipas Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale neni-129-131.

Punën në mes të qendrave regjionale të Shërbimit sprovues dhe Panelit për lirim me kusht e koordinon Divizioni i lirimit me kusht i cili funksionon në kuadër të Departamentit të Shërbimit Sprovues

Gjatë këtij viti, kemi pasur në mbikëqyrje 241 raste të personave të liruar me kusht nga burgu. Prej tyre mbikëqyrjen e kanë përfunduar me sukses 110 të liruar me kusht. Për këta të liruar me kusht janë përpiluar raporte informative dhe përfundimtare nga ana e zyrtarëve sprovues të cilat i janë dorëzuar Panelit për lirim me kusht. Zyrtaret e Shërbimit sprovues kanë hartuar 110 raporte përfundimtare dhe 101 raporte periodike për këta persona të liruara me kusht.

Gjatë këtij viti në Shërbimin sprovues kanë ardhur edhe 55 raste të reja të liruar me kusht nga burgjet e Kosovës. Nga numri i përgjithshëm i të liruave me kusht edhe 131 raste , ende janë nën mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues.

#### **V. Bashkëpunimi i Shërbimit Sprovues me institucionet tjera**

Shërbimi Sprovues i Kosovës , gjithmonë ka pas një bashkëpunim shumë të mirë me shumë institucione, organizata dhe shërbime të tjera. Asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë vërejtje apo konflikt.

#### **VI. Marrëveshje Bashkëpunimi me organizatat punuese nga ana e SHSK-së**

Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe organizata punuese për realizimin e punës me klient janë shumë me rëndësi si për organizatat punuese po ashtu edhe për klient. Shërbimi Sprovues ka marrëveshje bashkëpunimi me 120 organizata punuese në tërë Kosovën.

## VII. Përfundim

Për punën e Shërbimit sprovues për këtë vit japim këto përfundime:

- Bazë ligjore për punën e Shërbimit Sprovues në Kosovë janë: Kodi i Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për të Mitur dhe Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
- Staf i punonjës i SHSK-së tani ka 65 anëtarë, sipas buxhetit ky staf duhet të plotësohet edhe për katër punëtorë.
- Për këtë vit janë kryer më tepër se 1536 anketa sociale-raporte para ndëshkuese, përkatësisht janë vizituar më tepër se 2384 familje të klientëve.
- Kemi bërë ekzekutimin dhe kemi pasur në mbikëqyrje, 607 klient të dënuar me masa dhe dënime alternative;
- Kemi pas në mbikëqyrje 241 Persona të Liruar me kusht nga burgju;
- Në këtë vit janë realizuar 870 përfaqësime në seanca gjyqësore në prokurori dhe gjykata, nga ana e zyrtarëve sprovues sipas ftesave zyrtare të gjykatave
- Me punën dhe angazhimin e Shërbimit Sprovues të Kosovës përveç të tjerash është kursyer buxheti i Kosovës. Vlera e kursimit të buxhetit të Republikës së Kosovës për këtë nëntë mujor për rastet që janë në mbikëqyrje nga SHSK-ja me masa dhe dënime alternative për 679 raste (842x 365x10) është më tepër se 1.091.550.00 € , nëse harxhimet e një të burgosuri llogariten vetëm 10 € për 24 orë.
- Për të gjithë këta klient, zyrtari sprovues, ka vizituar: klientin, familjen, shkollën, qendrën për punë sociale, burgjet dhe institucione të tjera relevante.
- Volumi i punëve është shtuar në disa segmente në masë të konsiderueshme me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.